

## Përshkrimi i detyrave të punës

Pozita	Trajner (2 trajnerë)
Kodi i procedurës së rekrutimit	KIST - 01
Emërtimi i projektit ose programit	“Transformimi shoqëror inovativ në Kosovë” - KIST
Kodi dhe emërtimi i aktivitetit	Organizimi dhe mbajtja e trajnimeve me bazë në shkollë për Klubet Mediale të 10 shkollave partnere të projektit
#ditëve të punës	40 ditë pune /20 ditë pune për secilin trajner/e
Periudha e angazhimit	nëntor 2022 - mars 2023

### Qëllimi i konsulencës

Qëllimi i kësaj konsulence është ofrimi i trajnimeve për Klubet Mediale të shkollave partnere si dhe për arsimtarët/mentorët e këtyre klubeve e shkollave. Tema kryesore e këtij trajnimi është ofrimi dhe ngritja e kapaciteteve të shkollave partnere, në lidhje me përdorimin e përmbajtjes digjitale për qëllime kreative e edukative. Përveç kësaj, trajnimi përfshinë edhe zhvillimin e shkathtësive të pjesëmarrësve për përdorimin e teknikave të ndryshme të prodhimit, editimit dhe përdorimit të video-materialeve dhe materialeve tjera digjitale, të cilat bazohen në alternativat pozitive dhe narratives inspiruese kundër gjuhës së urrejtjes. Trajnimi poashtu, ka për fokus ndërtimin e narrativeve të përshtatshme për përdorimin e mediave sociale dhe filmit, si mjete për adresimin e dukurive negative në shoqëri.

### Përshkrimi i projektit/programit

Projekti ka për qëllim promovimin e edukimit digjital në arsim, duke ofruar udhëzime dhe materiale digjitale për shkollat, si dhe aktivitete kulturore e artistike, me synim rritjen e pjesëmarrjes aktive të nxënësve në jetën qytetare, adresimin e dezinformimit, dhe zhvillimin e të menduarit kritik në përballjen me sfidat e shekullit.

### Përshkrimi i hollësishëm i detyrave të punës

- Përgatit planin, metodologjinë dhe përmbajtjen e trajnimit;
- Përgatit materialet që duhet të shpërndahen te pjesëmarrësit në trajnim
- Siguron që përmbajtja e trajnimit të jetë gjithëpërfshirëse dhe në linjë me kornizën e kurrikulës;
- Elaboron teknika të ndryshme të prodhimit, editimit dhe përdorimit të video-materialeve dhe materialeve tjera digjitale
- Ndihmon në përgatitjet logjistike për zhvillimin e trajnimit, në veçanti sigurimi i materialeve për trajnim;
- Evidenton pjesëmarrësit në trajnimi;
- Mbledhë informata kthyesë nga pjesëmarrësit, në formë të vlerësimit ose në forma të tjera të përshtatshme;

- Harton raportin për rrjedhën e trajnimit;
- Ofron përkrahje në punët e tjera me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes së trajnimit me kërkesën e menaxherit përgjegjës.
- Dorëzon raportin, fletëvlerësimet dhe dokumentacionin e trajnimit tek menaxheri përgjegjës;

### Rezultatet e pritshme

**Rezultati 1:** Nxënësit dhe mësuesit pjesëmarrës në trajnim do të jenë në gjendje të kuptojnë modalitetet e zhvillimit të përmbajtjes digjitale;

**Rezultati 2:** Nxënësit do të mësojnë ta përdorin përmbajtjen digjitale për qëllimin e zhvillimit të tyre profesional e personal;

**Rezultati 3:** Nxënësit do të jenë në gjendje të adresojnë apo trajtojnë drejt rreziqet e mundshme që mund të dalin nga lajmet e reze apo dezinformata;

**Rezultati 4:** Staf i shkollës do të jetë më mirë i përgatitur për të adresuar sfidat që kanë të bëjnë me burimet digjitale si dhe me pasojat që nxënësit mund ta ballafaqojnë si rezultat i këtyre burimeve.

### Kualifikimet

- Kualifikim i nivelit bachelor, preferohet niveli Master në shkencë sociale (përparësi kanë ata/o nga fusha e edukimit, sociologjisë, psikologjisë apo të ngjashme dhe që kanë aftësi të dëshmuara pedagogjike)
- Përvojë pune si trajner së paku 3 vjet në fushën e Edukimit Medial
- Përvojë së paku trivjeçare në hartimin dhe zhvillimin e përmbajtjeve të trajnimit dhe manualit dhe lehtësimin e trajnimit të mësuesve/nxënësve
- Njohuri të avancuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe pakove standarde softuerike, me qëllim të organizimit të punës.

### Raportimi

Konsulenti i raporton menaxherit të projektit, Granit Brajshori.

Raportet që dorëzohen te menaxheri i projektit janë: Raporti pas përfundimit të trajnimit si dhe Raporti pas çdo angazhimi tjetër në kuadër të aktiviteteve të projektit.